

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. _____, Akt

20.18

V E N D I M
PER RREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot me date *03.02.99*, une gjyqtarja e Gjykeses se Rrethit Tirane *Prurita Capi*, si shqyrtova kerkesen dhe materialin e paraqitur nga Ministria e Ekonomise Publike dhe Privatizimit per rregjistrimin e shoqerise tregtare "ALBAPOST" Tirane ne formen e nje shoqerie anonime :

KONSTATOVA SE :

Kerkuesi Ministria Ekonomise Publike dhe Privatizimit ka paraqitur kerkesen per te rregjistruar si person juridik shoqerine ne formen e nje shoqerie anonime "ALBAPOST" Tirane me kohezgjatje pa afat te caktuar, me kapital themeltar 500.000.000 leke i ndare ne 500.000 aksione, me aksioner te vetem Ministrine Ekonomise Publike dhe Privatizimit, me vlere nominale 1 000 leke, me objekt veprimtarie:

- Aktiviteti i te gjithë sherbimeve postare, te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi per postat, ne territorin e Shqiperise.

Shoqeria siguron ofrimin e sherbimit postar ne te gjithë territorin e Shqiperise. Sherbimet postare perfshijne: korrespondencen, letrat, kartpostalet, shtypshkrimet, mostrat, literaturen per te verbrit, paketat e vogla, koliposten, telefaksin, urdherpagesat. Aktiviteti postar mbulon fushat e meposhtme : prodhimin, emetimin, venien ne qarkullim dhe terheqjen nga qarkullimi te pullave postare dhe objekteve te lidhura me to, pranimin, perpunimin, vijimin dhe shperndarjen e objekteve postare. Pervec aktiviteteve postare te paraqitura me lart, Shoqeria mundet ne baze te kontratave perkatese te ndjeke aktivite te tjera si: sherbimet financiare dhe bankare, aktivite sigurimi, sherbime te transportit dhe te shperndarjes se librave dhe gazetave, bashkepunim ne sherbim telegrafik dhe te transmetimit te te dhenave me operatore qe ofrojne keto sherbime, bashkepunimin ne sherbimin telefonik publik, nepermjet kabinave telefonike publike me operoret qe ofrojne keto sherbime, sherbimin e ndermjetem te lidhur me qarkullimin e parave (kryerja e veprimeve bankare per llogari te te treteve), transferim parash, sherbime te tjera.

Dokumentacioni i paraqitur, akti i themelimit, statuti, urdheri nr.18 date 29.12.1998, i Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit dhe kerkesa per miratim ekspertit jane te plota dhe te bazuara ne ligj dhe si te tilla duhet te pranohen.

PER KETO ARSYE :

Ne baze te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite trgetare", si dhe nenit 33 ligjit Nr.7667, date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen plotesuar ne te".

V E N D O S A :

Rregjistrimin si person juridik te shoqerise anonime "ALBAPOST" Tirane, me kohezgjatje pa afat te caktuar me kapital themeltar 500.000.000 leke me aksioner te vetem Ministrine e Ekonomise Publike dhe Privatizimit, me vlere nominale te aksionit 1.000 leke dhe me objekt veprimtarie :

- Aktiviteti i te gjithë shërbimeve postare, te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi per postat, ne territorin e Shqiperise.

Shoqeria siguron ofrimin e shërbimit postar ne te gjithë territorin e Shqiperise. Shërbimet postare përfshijne: korrespondencen, letrat, kartpostalet, shtypshkrimet, mostrat, literaturen per te verbrit, paketat e vogla, koliposten, telefaksin, urdherpagesat. Aktiviteti postar mbulon fushat e mëposhtme : prodhimin, emetimin, venien ne qarkullim dhe tërheqjen nga qarkullimi te pullave postare dhe objekteve te lidhura me to, pranimin, perpunimin, vijimin dhe shpërndarjen e objekteve postare. Përveç aktiviteteve postare te paraqitura me lart, Shoqeria mundet ne baze te kontratave perkatese te ndjeke aktivitete te tjera si: shërbimet financiare dhe bankare, aktivitete sigurimi, shërbime te transportit dhe te shpërndarjes se librave dhe gazetave, bashkëpunim ne shërbim telegrafik dhe te transmetimit te te dhenave me operatore qe ofrojne keto shërbime, bashkëpunimin ne shërbimin telefonik publik, nepermjet kabinave telefonike publike me operoret qe ofrojne keto shërbime, shërbimin e ndërmjetem te lidhur me qarkullimin e parave (kryerja e veprimeve bankare per llogari te te treteve), transferim parash, shërbime te tjera.

- Keshilli mbikqyres perbehet nga :

- Viron ANDREA
- Kristi MIMA
- Trajan VASILI
- Dhurata KURTI
- Klodjana HASANAJ
- Mustafa MUCI

Kunder vendimit lejohet ankimi ne shkalle te dyte.

G J Y Q T A R E

Aranda Cep

[Signature]

URDHER REGJISTRIMI

Me

1. *20.718*
- 2.a. *'Dilba Post - S.H.A*
- b. *500.000.000 lek.*
- c. *Ditoheteto 1 shprehese te
g. teu postare etj.*

- c. *Taluzgjetje pe ofot*
3. *Viton Tondrice
Tuzita Shimez
Erzhan Voveli Skurtafa Kuci
Bemete Tuzita
Tebonane Florouaj*

4. Statuti nerishkruar me date *12.01.99*
5. Data e uqj. d. n. n. ut *03.02.99*

Statuti *9* Fietc

- Njoftime. a shoqeria
- b. dhomen e tregtise
- c. organit perfaqes financiar
- d. zyres se statistikes

Publikime

BUYQIARE
Amila Cops
CH

AKT -THEMELIMI I SHOQERISE ANONIME

Ne Tirane, sot me date _____, ne baze te Ligjit Nr.8237, date 1.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr.1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr.8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr.1631, date 1.11.1996 dhe Ligjin Nr.8158, date 7.11.1996, Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit


VENDOSI:

1. Te krijoje shoqerine anonime "Alba-Post" Tirane Sh.A.
2. Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :
Aktiviteti i te gjithë shërbimeve postare, te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi per postat, ne territorin e Shqiperise.
Shoqeria siguron ofrimin e shërbimit postar ne te gjithë territorin e Shqiperise. Shërbimet postare përfshijne: korrespondencen, letrat, kartpostalet, shtypshkrimet, mostrat, literaturen per te verbrit, paketat e vogla, koliposten, telefaksin, urdherpagesat. Aktiviteti postar mbulon fushat e mëposhtme : prodhimin, emetimin, venien ne qarkullim dhe tërheqjen nga qarkullimi te pullave postare dhe objekteve te lidhura me to, pranimin, përpunimin, vijimin dhe shpërndarjen e objekteve postare. Përvec aktiviteteve postare te paraqitura me lart, Shoqeria mundet ne baze te kontratave perkatëse te ndjeke aktivitete te tjera si: shërbimet financiare dhe bankare, aktivitete sigurimi, shërbime te transportit dhe te shpërndarjes se librave dhe gazetave, bashkëpunim ne shërbim telegrafik dhe te transmetimit te te dhenave me operatore qe ofrojne keto shërbime, bashkëpunimin ne shërbimin telefonik publik, nepermjet kabinave telefonike publike me operatoren qe ofrojne keto shërbime, shërbimin e ndërmjetem te lidhur me qarkullimin e parave (kryerja e veprimeve bankare per llogari te te tereve), transferim parash, shërbime te tjera.
3. Shoqeria do te kete seline e saj ne Tirane dhe ajo mund te cele dege, filiale, agjensi dhe perfaqesi ne te gjithë teritorin e Republikës se Shqiperise dhe me miratimin e organeve kopetente edhe jashte shtetit.
4. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 500.000.000 leke i ndare ne 500.000 aksione me vlere nominale 1000 leke.
5. Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj pa afat te caktuar.
6. Keshilli i pare mbikqyres perbehet nga :
 - Viron ANDREA
 - Kristi MIMA

- Trajan VASILI
- Dhurata KURTI
- Klodjana HASANAJ
- Mustafa MUCI

7. Ndertimi, organizimi dhe funksionimi i shoqërisë rregullohet sipas dispozitave të legjislativës shqiptare si dhe në bazë të statutit dhe këtij akti themelimi.

8. Shoqëria fillon veprimtarinë me nënshkrimin dhe miratimin e dokumentave të saj themeluese.



STATUTI
I
SHOQERISE ANONIME PA OFERTE PUBLIKE

“ALBA POST”

NENI 1

Emertimi dhe selia

Shoqeria anonime krijohet nga transformimi i Ndermarrjes se Postave Shqiptare. Shoqeria e krijuar ne kete menyre emertohet “ALBA POST” sh.a.

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga “Rreshit Collaku”, nr. 4, Tirane.

NENI 2

Objekti i shoqerise

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte aktiviteti i gjithe sherbimeve postare, te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi per postat, ne territorin e Shqiperise.

Shoqeria siguron ofrimin e sherbimit postar ne te gjithe territorin e Shqiperise.

1- Sherbimet postare perfshijne:

korrespondencen, letrat, kartpostalet, shtypshkrimet, mostrat, literaturen per te verbrit, paketat e vogla, koliposten, telefaksin, urdherpagesat.

2- Aktiviteti postar mbulon fushat e mepostme :

prodhimin, emetimin, venjen ne qarkullim dhe terheqjen nga qarkullimi te pullave postare dhe objekteve te lidhura me to, pranimin, perpunimin, vijimin dhe shperndarjen e objekteve postare.

3- Pavec aktiviteteteve postare te paraqitura me lart, Shoqeria mundet ne baze te kontratave perkatese te ndjeke aktivitetete te tjera si:

sherbimet financiare dhe bankare, aktivitete sigurimi, sherbime te transportit dhe te shperndarjes se librave dhe gazetave, bashkepunim ne sherbim telegrafik dhe te transmetimit te te dhenave me operatore qe ofrojne keto sherbime, bashkepunimin ne sherbimin telefonik publik, nepermjet kabinave telefonike publike me operatoret qe ofrojne keto sherbime, sherbimin e ndermjetem te lidhur me qarkullimin e parave (kryerja e veprimeve bankare per llogari te te treteve), transferim parash, sherbime te tjera.



Shoqeria brenda caqeve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, do te kryeje çdo operacion tregëtar dhe financiar qe lidhet drejtperdrejte ose terethorazi me objektin e saj. Kjo perfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqerive te reja, si dhe pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera brenda dhe jashte vendit.

NENI 3

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me afat te papercaktuar.

NENI 4

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar eshte 500.000.000 leke.

Nga kjo vlera e truallit eshte 22.853.003 leke. Numri i aksioneve eshte 500.000.

Vlera nominale e aksionit eshte 1000 leke.

Pronari i vetem i aksioneve eshte Shteti Shqiptar i perfaqesuar nga Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit.

NENI 5

Transferimi i aksioneve ne rast privatizimi

Transferimi i aksioneve ne rastin e privatizimit do te kryhet me Urdher te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit ne baze te legjislacionit ne fuqi per privatizimin.

NENI 6

Organet drejtuese

Organet drejtuese te shoqerise jane:

1. Keshilli Mbikqyres;
2. Drejtoria.

NENI 7

Keshilli Mbikqyres

- 1) Keshilli Mbikqyres perbehet nga 6 (gjashte) anetare. Anetaret e Keshillit Mbikqyres emerohen nga Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit.
- 2) Anetaret e Keshillit Mbikqyres duhet te jene eksperte ne nje nga keto fusha: ekonomi, jurisprudence.
- 3) Kohezgjatja e funksionit te tyre eshte 4 vjet. Anetaret e Keshillit Mbikqyres jane te gjithë te rizgjedhshem. Ata mund te shkarkohen ne cdo moment nga Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit.
- 4) Anetaret e Keshillit Mbikqyres jane persona fizike. Ata nuk mund te jene punesuar ne shoqeri.
- 5) Nese nje ose disa vende te anetareve te Keshillit Mbikqyres mbeten bosh per shkak



vdekje, shkarkimi ose doreheqje, zevendesimi duhet te kryhet jo me vone se 3 (tre) muaj. Anetari i Keshillit Mbikqyres i emeruar me zevendesim te nje anetari tjetër, perfundon mandatin e paraardhesit.

- 6) Anetaret e Keshillit Mbikqyres nuk mund te bejne pjese ne me shume se 3 (tre) keshilla mbikqyres te shoqerive anonime qe e kane seline ne territorin e Republikes se Shqiperise.
- 7) Anetaret e Keshillit Mbikqyres te moshes mbi 65 (gjashtedhete e pese) vjeç nuk mund te jene me shume se 1/3 (nje e treta) e numrit te pergjithshem te Keshillit Mbikqyres. Ne se ky raport tejkalohej anetari me i moshuar do te quhet i shkarkuar zyrtarisht.

NENI 8

Kryetari dhe zevendes kryetari i Keshillit Mbikqyres

Keshilli Mbikqyres zgjedh ndermjet anetareve te tij nje kryetar dhe nje zevendes kryetar, te cilet therresin mbledhjen e Keshillit dhe drejtojne diskutimet. Ata zgjidhen per te gjithë kohen e mandatit te tyre dhe jane te rizgjedhshem.


Keshilli Mbikqyres mund te caktojë nje person si sekretar edhe jashte anetareve te tij.

Ne rast mungese ose pengimi te kryetarit, mbledhjet e Keshillit Mbikqyres drejtohen nga zevendes kryetari.

NENI 9

Mbledhjet dhe vendimet e Keshillit Mbikqyres

- 1) Keshilli Mbikqyres mblidhet te pakten nje here ne 3 (tre) muaj dhe sa here qe e kerkon interesi i shoqerise, me thirrjen e kryetarit, ose ne mungese te tij, te zevendes kryetarit. Ai mblidhet gjithashtu ne fund te çdo tremujori per te degjuar raportin e Drejtorit.
- 2) Kryetari duhet te therrase mbledhjen e Keshillit Mbikqyres brenda 15 (pesembedhete) diteve kur Drejtoria ose 1/3 (nje e treta) e anetareve te Keshillit Mbikqyres i paraqesin atij nje kerkese te motivur per kete qellim. Nese kerkesa mbetet pa pergjigje, atehere autoret e saj mund te therresin mbledhjen e Keshillit Mbikqyres, duke percaktuar rendin e dites. Ne parim thirrja duhet te behet 3 (tre) dite perpara, me leter, telegram, teleks, ose faks. Por thirrja mund te jete e vlefshme edhe me goje dhe pa afat nese anetaret e Keshillit Mbikqyres do ta pranojne ate. Çdo thirrje duhet te percaktojë rendin e dites. Mbledhja e Keshillit Mbikqyres zhvillohet ne seline e shoqerise ose ne çdo vend tjetër te percaktuar ne thirrje.
- 3) Keshilli Mbikqyres mund te marre nje vendim te vlefshem vetem nese jane te pranishem jo me pak se gjysma e anetareve te tij. Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem, ne rast barazimi votash, ajo e kryetarit eshte percaktuese.
- 4) Per çdo mbledhje te Keshillit Mbikqyres hartohet nje proces verbal i cili permban :
 - daten dhe vendin e mbledhjes;
 - menyren e thirrjes;
 - rendin e dites;
 - drejtuesin e mbledhjes;
 - permblidhjen e dokumentave dhe te raporteve qe jane shtruar ne mbledhje;



- një përmbledhje të debateve;
- rezultatet e votimeve.

Proçes verbalet e mbledhjes së Keshillit Mbikqyres mbahen në një regjister të posaçëm. Ato nënshkruhen nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

- 5) Vendimet e Keshillit Mbikqyres evidentohen nga proces verbalet që mbahen në mbledhje në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi nga kryetari ose zëvendeskryetari.
- 6) Vendimet vërtetohen nga kryetari ose zëvendeskryetari i Keshillit Mbikqyres.
- 7) Keshilli Mbikqyres, nëse e sheh të arsyeshme, mund të thërrasë në mbledhjet e tij Drejtorinë.

NENI 10

Te drejtat dhe detyrat e Keshillit Mbikqyres

- 1) Keshilli Mbikqyres emëron anëtarët e Drejtorisë kur janë dakort jo më pak se 2/3 (dy të tretat) e të gjithë anëtarëve të keshillit mbikqyres.
- 2) Keshilli Mbikqyres cakton njerin prej anëtarëve të Drejtorisë me cilesinë e Drejtorit.
- 3) Me emërimin e anëtarëve të Drejtorisë, Keshilli Mbikqyres lidh kontratë me ta për detyrimet që rrjedhin në administrimin e shoqërisë.
- 4) Keshilli Mbikqyres autorizon Drejtorinë që të kryejë veprimet dhe të realizojë marrëveshjet e parashikuara në nenet 14 dhe 17 të statutit.
- 5) Keshilli Mbikqyres emëron Drejtorat e Qendrave Rajonale.
- 6) Keshilli Mbikqyres ushtron kontroll të përhershëm për administrimin e shoqërisë nga Drejtoria dhe i jep kesaj të fundit autorizimin për kryerjen e operacioneve që nuk mund të kryhen nga Drejtoria pa autorizimin e Keshillit Mbikqyres.
- 7) Keshilli Mbikqyres ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikime dhe kontrole që ai i çmon të përshtatshme dhe të njihet me dokumentacionin që e gjykon të nevojshëm për përbushjen e detyrës së tij.
- 8) Keshilli Mbikqyres mund të thërrasë në mbledhjet e tij palë të treta për qëllime keshillimi.
- 9) Drejtoria i paraqet raport Keshillit Mbikqyres mbi realizimin e treguesve teknikë, ekonomikë, financiarë e cilësorë të planifikuar çdo tremujor dhe në mënyrë progresive, dhe në raste të vecanta edhe për periudha kohore më të shkurtra, kur gjykohet se një veprim i tillë është i domosdoshëm për mbarevajtjen e punëve të shoqërisë. Brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar Drejtoria duhet t'i paraqesë Keshillit Mbikqyres llogaritë vjetore me qëllim verifikimi dhe kontrolli, së bashku me raportet përkatëse për të eksperteve kontabel të autorizuar, si dhe të saj.
- 10) Keshilli Mbikqyres i propozon Ministrisë të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit lidhur me keto çështje:
 - a) përcaktimin dhe ndryshimin e programit afatshkurter, afatmesëm dhe afatgjatë të veprimtarisë të shoqërisë;
 - b) kryerjen e investimeve dhe financimeve për vitin financiar si dhe masat e tjera që do kërkonin ndryshimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
 - c) hapjen e veprimtarive ose pjesëve të reja dhe ndryshimin e objektit të shoqërisë;
 - d) shitjen e pasurive që përbejnë aktivin e qendrueshëm të shoqërisë;
 - e) krijimin e shoqërive të reja dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera;



- f) marrjen e huave afatmesme, afatgjata;
- g) per çdo çeshtje tjetër që në baze të ligjit "Per shoqerite tregtare" është kompetence e Asamblese së Pergjithshme.

Keshilli Mbikqyres:

- h) miraton struktura të përgjithshme organizative të shoqerisë dhe të Aparatit Administrativ të Drejtorisë sipas propozimit të bërë prej saj;
- i) miraton rregulloren e brendshme të shoqerisë të propozuar nga Drejtoria, në të cilën përcaktohen dhe detyrat e çdo anetari drejtorie;
- j) miraton pagat e anetareve të Drejtorisë, si dhe struktura të pagave të shoqerisë në përputhje me vendet e punës të miratuara;
- k) miraton rast pas rasti sponsorizimet mbi bazën e kërkesave që i kanë ardhur nga Drejtoria;
- l) miraton kriteret e vendeve të punës, të marrjes në punë dhe shpërblimit e punonjësve të shoqerisë;
- m) shqyrton studime të rëndësishme të përgatitura nga Drejtoria dhe ja paraqet ato për miratim Ministrit.

- n) përcakton vlerën e kontratës për të cilën drejtoria para se të lidhet është e detyruar të marrë autorizimin e Keshillit Mbikqyres.

NENI 11

Shpërblimi i anetareve të Keshillit Mbikqyres

Shpërblimi i anetareve të Keshillit Mbikqyres do të bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në Vendimin e Keshillit të Ministrave.

NENI 12

Drejtoria

- 1) Shoqeria administrohet nga Drejtoria. Numri i anetareve të Drejtorisë caktohet nga Keshilli Mbikqyres me një vendim të tij. Ata duhet të jenë specialiste në një nga këto fusha: shërbim postar, ekonomi ose jurisprudencë.
- 2) Drejtoria emërohet nga Keshilli Mbikqyres kur për të janë dakord jo më pak se 2/3 (dy të tretat) e të gjithë anetareve të kësaj Keshilli. Përzgjedhja e tyre bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara për marrjen në punë.
- 3) Anetarët e Drejtorisë janë persona fizikë, në të kundërt emërimi i tyre është i pavlefshëm. Ata mund të zgjidhen edhe jashtë të punësuarve në shoqëri. Nëse një anetar i Keshillit Mbikqyres emërohet anetar i Drejtorisë, mandati i tij në Keshill Mbikqyres perfundon. Një person nuk mund të emërohet anetar drejtorie ose drejtor në më shumë se një shoqëri. Anetarët e Drejtorisë mund të shkarkohen nga Keshilli Mbikqyres për shkak të perligjura. Në rastin kur i interesuari ka lidhur kontratë punësimit me shoqërinë, shkarkimi i tij nga funksioni i anetarit të Drejtorisë nuk është shkak për zgjidhjen e kontratës.
- 4) Anetarët e Drejtorisë emërohen në një periudhë kohe prej 4 (katër) vjetësh. Në rastet e pushimeve dhe mungesave të zgjatura, Keshilli Mbikqyres bën zëvendësimin e tyre.
- 5) Anetarët e Drejtorisë janë të riemërueshëm, ata nuk mund të jenë mbi moshën 65



(gjashtedhjetë e pesë) vjeç. Anetari i Drejtorise që mbush moshën 65 (gjashtedhjetë e pesë) vjeç konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.

6) Paga e anetareve të Drejtorise caktohet nga Keshilli Mbikqyres në aktin e emerimit të tyre.

NENI 13

Te drejtat dhe detyrat e Drejtorise

- 1) Drejtoria përfaqëson shoqërinë në lidhje me të tretet.
- 2) Drejtoria ka kompetencë të plotë për të vepruar në emër të Shoqërisë me përjashtim të rasteve kur kësaj kompetencë i perkasin asamblëse ose keshillit mbikqyres.
- 3) Në marrëdhëniet me të tretet Shoqëria merr përsipër detyrime që rrjedhin nga aktet e Drejtorise të nënshkruara nga anetari me cilesinë e Drejtorit edhe kur këto e tejkalojnë objektin e veprimtarisë së saj, përveç rastit kur Shoqëria provon se të tretet e dinin që akti i Drejtorise kapërcente objektin e veprimtarisë së Shoqërisë dhe vepronte me keqbesim, ose kur të tretet nuk mund të injoronin këtë akt, duke pasur parasysh faktin se shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.
- 4) Aktet me të cilat Shoqëria merr përsipër detyrimet ndaj të treta duhen të nënshkruhen nga anetari me cilesinë e drejtorit ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit për këtë akt.
- 5) Anetaret e Drejtorise janë të gjithë përgjegjës për ushtrimin e duhur të funksioneve që i janë caktuar Drejtorise dhe për zbatimin e vendimeve të Keshillit Mbikqyres.
- 6) Drejtoria është përgjegjëse për menaxhimin ekonomik të shoqërisë. Ajo është përgjegjëse në veçanti për:
 - përpilimin e planit ekonomik-financiar;
 - përpilimin e gjendjes financiare vjetore dhe raportimin e saj;
 - përpilimin e raportit vjetor;
 - berjen e marrëveshjeve kolektive me punonjësit e shoqërisë.
- 7) Drejtoria merr vendim me shumicë të thjeshtë votash të anetareve të pranishëm kur janë prezent jo më pak se gjysma e anetareve të saj. Në rast barazimi votash, vota e anetarit të caktuar me cilesinë e drejtorit është përcaktuese.
- 8) Drejtoria bën strukturën e organizimit të Shoqërisë, të cilën e miraton Keshilli Mbikqyres.
- 9) Emeron dhe shkarkon në përputhje me dispozitat që rregullojnë marrëdhëniet e punës, të gjithë punonjësit e shoqërisë.
- 10) Drejtoria është përgjegjëse në raportimin ndaj Keshillit Mbikqyres. Ajo duhet t'i paraqesë raportet Keshillit Mbikqyres në intervale të rregullt, të pakten një herë në tre muaj. Për më tepër, Drejtoria duhet t'i raportojë kryetarit të Keshillit Mbikqyres për çdo rast tjetër të veçantë.
- 11) Drejtoria është përgjegjëse në dënimin e informacionit Keshillit Mbikqyres për aspekte të menaxhimit të biznesit të shoqërisë.

NENI 14

Ruajtja e sekretit

Anetaret e Keshillit Mbikqyres, Drejtorise si dhe punonjësit e tjerë të shoqërisë detyrohen të ruajnë sekretin edhe pas largimit nga shoqëria për të dhënat që kanë karakter të brendshëm,



te cilat jane percaktuar e miratuar nga Drejtoria dhe ju jane bere te njohura punonjesve.

NENI 15

Marreveshjet ndermjet shoqerise dhe Drejtorise ose te nje anetari te Keshillit Mbikqyres

Çdo marreveshje ndermjet shoqerise dhe anetareve te Drejtorise ose nje anetari te Keshillit Mbikqyres, qofte e drejtperdrejte ose jo e drejtperdrejte duhet t'i nenshtrohet autorizimit paraprak te Keshillit Mbikqyres.

Percaktimi i mesiperm eshte i vlefshem edhe per marreveshjet ndermjet shoqerise dhe nje shoqerie tjeter, kur nje anetar i Keshillit Mbikqyres eshte edhe anetar i keshillit mbikqyres te nje shoqerie tjeter, me te cilen propozohet te lidhet marreveshje. Kjo nuk eshte e zbatueshme per marreveshjet qe kane te bejne me veprimtarine rrjedhese te shoqerise qe kryhen ne kushte normale.

Anetari i Drejtorise ose i Keshillit Mbikqyres i interesuar duhet te njoftoje Keshillin Mbikqyres per nje marreveshje per te cilen zbatohen kerkesat e ketij neni te statutit. Anetari i interesuar i Keshillit Mbikqyres nuk merr pjese ne votimin per dhenien e autorizimit.

NENI 16

Eksperti kontabel i autorizuar

Kontrolli i shoqerise ushtrohet nga _____ eksperte kontabel te autorizuar, te cilet emerohen nga aksionmbajtesi i vetem dhe qe kryejne misionin e tyre ne pajtim me ligjin.

NENI 17

Ushtrimi financiar

Ushtrimi financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.

Perjashtimisht ushtrimi financiar perfshin kohen nga data e regjistrimit ne regjistrin tregtar deri me 31 Dhjetor.

NENI 18

Plani ekonomik

Drejtoria ne perputhje me aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi dhe udhezimet e leshuara nga pronari, si dhe te specifikave te shoqerise, harton plane zhvillimi per periudha aftashkurtera, afatmesme e afatgjata, me te gjitha treguesit teknike, ekonomike e financiare dhe ia paraqet ato Keshillit Mbikqyres, i cili i shqyrton dhe ben permiresimet qe ai i gjykon te nevojshme dhe te mundshme. Pas kesaj, plani i paraqitet per shqyrtim e miratim pronarit.

NENI 19

Inventari - Llogarite vjetore

Shoqeria do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe te veprimtarise se saj ne pajtim me kerkesat ligjore. Ne mbyllje te ushtrimit, Drejtoria harton inventarin e pasurise ne



kete date dhe llogarite vjetore per ushtrimin financiar. Drejtoria pergatit gjithashtu edhe raportin e administrimit per gjendjen e shoqerise gjate ushtrimit financiar.

NENI 20

Rezultati i ushtrimit dhe percaktimi i fitimit

Rezultati i ushtrimit percaktohet si diferenca ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem.

Nga fitimet e ushtrimit, te pakesuara kur eshte rasti me humbjet e meparshme, hiqet te pakten 5% e fitimit (pese perqind) per te krijuar rezerven e domosdoshme.

Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme nuk eshte e detyrueshme kur kjo rezerve arrin 1/10 (nje te dhjeten) e kapitalit themeltar. Ajo rifillon per nje arsye cfaredo, kur rezerva e domosdoshme ka zbritur nen 1/10 (nje te dhjetat) e kapitalit.

Perdorimi i fitimit pas zbritjes se rezerves ligjore behet me urdher te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit.

NENI 21

Emerimi i anetareve te Keshillit Mbikqyres

Si anetare te pare te Keshillit Mbikqyres emerohen:

- 1) Z. Viron ANDREA
- 2) Z. Kristi MIMA
- 3) Z. Trajan VASILI
- 4) Z. Dhurata KURTI
- 5) Z. Klodjana HASANAJ
- 6) Z. Mustafa MUCI

NENI 22

Emerimi i eksperteve te pare te autorizuar

Eksperte te pare kontabel te autorizuar emerohen:

- 1) Z. Robert PASHKO
- 2) Zj. Mimoza SULA

NENI 23

Asambleja e pergjithshme

Te gjitha kompetencat e asamblese se pergjithshme te parashikuar nga ligji Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" qe nuk jane shprehur ne kete statut, ushtrohen nga Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit me cilesine e aksionerit te vetem.



Dispozita te fundit

NENI 24

Ne nje afat prej 6 (gjashte) muajsh nga data e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar, Drejtori i shoqerise do te jete Drejtori i ish-ndermarrjes shteterore. Gjate ketij afati ai mund te shkarkohet nga Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit veç per shkaqe te perligjura.

NENI 25

Per çfare nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet dispozitave te legjislacionit ne fuqi per shoqerite tregtare.

